

AKTI I THEMELIMIT  
TË  
SHOQËRISË ME PËRGGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
„COLORADO UNIVERSITY OF TIRANA“ sh.p.k  
(CUT) sh.p.k



Sot, në Tiranë, më datë 28.09.2007, personat e mëposhtem:

Gentian Stroni, i biri i Pandeliut dhe i Androniqit, datelindja 12.11.1969, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, rruga "Bajram Curri", pallatet "1 Maji", shk 6/1, dhe me adrese të perkohshme në Californi, 7040 Archibald ave apt 92, Alta Loma Ca 91701, mbajtes i pasaportes Z0180301

Kizzy Godwin Kurtis Kalu, datelindja 30.05.1964, shtetas amerikan, banues në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Teikyo Loretto Heights University Campus 3001 S. Federal Blvd, Denver Co 80236-2, mbajtes i pasaportes amerikane nr 0773068975, date 06.07.2004

Themelojnë shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar „COLORADO UNIVERSITY OF TIRANA“ (CUT) sh.p.k dhe hartojnë për këtë qëllim Aktin e Themelimit të shoqërisë me përmbajtje si vijon:

NENI 1  
EMËRTIMI I SHOQËRISË

1.1 Emërtimi i shoqërisë është „COLORADO UNIVERSITY OF TIRANA“ sh.p.k, emri i shkurtuar (CUT) sh.p.k.

NENI 2

Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shoqiptar në fuqi dhe vecanërisht mbështetur në nenin 2 paragrafi „B“ i Ligjit „Për sanksionet dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë të veprimtarisë private, të pavarur dhe të privatizimit“, në legjislacionin në fuqi, "Për Shoqëritë Tregtare", në të cilën ata janë ortakë dhe për këtë qëllim hartojnë Aktin e Themelimit të tij, me përmbajtjen si vijon:

NENI 3  
FORMA

Shoqëria „COLORADO UNIVERSITY OF TIRANA“ sh.p.k, emri i shkurtuar (CUT) sh.p.k.

është Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuar sh.p.k.

NENI 4  
SELIA

4.1 Sella e shoqërisë është në rrugën „A. Moisiu“ godina nr 3, perballe ish ndërhyrjes Rruga-Ura Tiranë.

NENI 5  
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

• Aktivitet në fushën e arsimit jopublik privat, kopshte e cerdhe për femije, shkollë e ciklit të ulët, të mesëm e të lartë universitar, me drejtim të përgjithshëm e profesional, kolegje dhe kurse afatshkurter, afatmesëm e afatgjatë para dhe pasuniversitar.

• Import-eksport dhe tregtim me shumicë e pakice të të gjitha llojeve të mallrave për llogari të vete shoqërisë dhe të të tjerëve dhe në vecanti të produkteve kimike, farmaceutike, materialeve mjeksore, stomatologjike e kirurgjikale, pajisje mjeksore e stomatologjike, kite, reagente, materiale konsumi për laboratore, pajisje dhe sisteme kompjuterike dhe cdo artikulli dhe malli, pa kufizim, që lejohet nga legjislacioni shoqiptar në fuqi dhe që ka lidhje me aktivitetin privat të shoqërisë etj.

NENI 6

Kobëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat dhe do të fillojë nga momenti i regjistrimit të saj në Qendren Kombëtare të Regjistrimit me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos asambleja e ortakëve

NENI 7  
TERRITORI

7.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, gjithashtu ajo mund të hapë, fillale, degë, ose përfaqësi në rreth të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, apo në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

NENI 8  
KAPITALI DHE PJESËT

8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë ka vlerën 100 000 lekë (njëqindmijë) i cili ndahet në 100 pjesë secila me vlerë prej 1000 lekë.

8.2 Kapitali themeltar i shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të marrë prej ortakëve. Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar nëpërmjet shtimit të pjesëve të reja, ortakët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e pjesëve të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.

8.3 Kapitali themeltar i shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të marrë nga e Asamblesë së Ortakëve. Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që ata përfaqësojnë.

NENI 9  
KONTRIBUTET

9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë, zotërohet nga ortakët e shoqërisë Gentian Stroni dhe Kizzy Godwin Kurtis Kalu si vijon:

9.2 Ortaku Gentian Stroni zotëron 50 % të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 50 pjesë, me vlerë totale prej 50 000 lekë (pesedhjetë mijë).

9.3 Ortaku Kizzy Godwin Kurtis Kalu, zotëron 50 % të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 50 pjesë, me vlerë totale prej 50 000 lekë (pesedhjetë mijë).

9.4 Vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë është shlyer plotësisht me kontributin e ortakëve sipas raportit të paraqitur më sipër.

9.5 Për nevoja të punës dhe të ushtrimit të aktivitetit të saj shoqëria mund të çelë llogari në çdo bankë të njohur me ligj, qoftë kjo private ose shtetërore.

NENI 10  
ADMINISTRIMI

10.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë të cilët janë persona fizike të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj, një i emëruar me përfaqësimin e ortakëve me shumicë dhe tjetri në përfaqësimin e ortakëve në pakicë.

10.2 Në vazhdim administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të ortakëve që përfaqësojnë mbi 75 % e pjesëve të kapitalit themeltar.

10.3 Emërimi i administratorit ose administratorëve bëhet për një afat 3(tre) vjeçar, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi kompetent mund të bëhet në çdo kohë.

NENI 11  
KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

11.1 Administratorëve iu njihet e drejta për të ushtruar të gjitha kompetencat për kryerjen e veprimeve të administrimit dhe të përfaqësimit në emër të shoqërisë, në interes të saj dhe nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e Shoqërisë, Principet e Biznesit dhe vendimet e Asamblesë së ortakëve të shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që ligji dhe statuti ia japin shprehimisht ortakëve.

NENI 12  
EMËRIMI I PARË I ADMINISTRATORËVE

Administrator i shoqërisë për periudhën 3-vjeçare emërohen ortakët e shoqërisë Gentian Stroni dhe Kizzy Godwin Kurtis Kalu të cilët kanë të drejtë të veprojnë në emër të bashku ose secili veç e veç sipas rastit.

Akti i Themelimit u përpilua në gjuhën shqipe, në katër kopje origjinale, duke pasur të gjitha fuqitë ligjore të barabarta për t'u administruar sipas ligjit.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Gentian Stroni

Kizzy Godwin Kurtis Kalu

*Gentian Stroni*

*Kizzy Godwin Kurtis Kalu*  
Përkthyes: Kristina Sheperi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË  
NR/0891 REP NR 2303-KOL  
Notere Dhimitra QARRI  
Adresa: Blv „B Curri“ pranë Gjykatës së  
Rrethit Gjyqësor Tiranë Tel 251 200/0692095871

VERTETIM NENSHKRIMI

Në Tiranë sot me datën 06.12.2007, para meje noterës publike Dhimitra Qarri, u paraqiten personalisht,

Gentian Stroni, i biri i Pandeliut dhe i Androniqit, datelindja 12.11.1969, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, rruga "Bajram Curri", pallatet "1 Maji", shk 6/1, dhe me adrese të perkohshme në Californi, 7040 Archibald ave apt 92, Alta Loma Ca 91701, mbajtes i pasaportes Z0180301.

Kizzy Godwin Kurtis Kalu, datelindja 30.05.1964, shtetas amerikan, banues në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Teikyo Loretto Heights University Campus 3001 S. Federal Blvd, Denver Co 80236-2, mbajtes i pasaportes amerikane nr 0773068975, date 06.07.2004, me cilesine e ortakëve të shoqërisë „COLORADO UNIVERSITY OF TIRANA“ (CUT) sh.p.k madhore, me zotësi të plote juridike për të vepruar, të cilet me vullnet të lire e të plote deklaruan se sa me sipër është akti për themelimin e shoqërisë, përpiluar prej tyre jashtë kesaj zyre noteriale, nënshkruar në praninë time dhe une noterja e vertetoj ate konform ligjit.

Komunikimi me shtetasin Kizzy Godwin Kurtis Kalu u bë në gjuhën angleze nepermjet perkthyeses Kristina Sheperi e njohur personalisht prej meje noterës.



NOTERE  
Dhimitra Qarri

001  
PULJE TAKSE  
3548 3310